



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 3 tetor 2024
Nr. ref.:RK 2542/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI270/23

Parashtrues

Muhamed Mustafa Lahu

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [PN. nr. 689/2023]
të 4 korrikut 2023 të Gjykatës së Apelit të Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Muhamed Mustafa Lahu, me vendbanim në Vushtrri (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga avokati Engjëll Rexhepi.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin [PN. nr. 689/2023] e 4 korrikut 2023 të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) në ndërlidhje me Aktvendimin [P. nr. 205/21] e 5 majit 2023 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E Drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa Individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 7 dhjetor 2023, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata). Të njëjtën ditë, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dorëzoi në Gjykatë autorizimin për përfaqësim.
6. Më 27 dhjetor 2023, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [nr. Gjr. KI270/23] caktoi gjyqtarin Enver Peci gjyqtar raportues dhe me Vendimin [nr. KSH. KI270/23] caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban (anëtarë).
7. Më 27 dhjetor 2023, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit.
8. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
9. Më 10 maj 2024, Gjykata e njoftoi Gjykatën Themelore për regjistrim të rastit dhe kërkoi nga ajo që të dorëzojë në Gjykatë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi e ka pranuar vendimin e kontestuar.
10. Më 21 maj 2024, Gjykata Themelore në Mitrovicë dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën e kërkuar.
11. Më 4 shtator 2024, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Nga shkresat e lëndës rezulton se, më 11 qershor 2015, Njësia Rajonale e Komunikacionit – Mitrovicë (në tekstin e mëtejme: Policia e Kosovës), ka paraqitur kallëzimin penal [nr. 2015-BR-211] kundër parashtruesit të kërkesës, nën dyshimin e bazuar se i njëjti ka kryer veprën penale “*Rrezikim i Trafikut Publik*” nga pika 9, paragrafi 1 i nenit 378 të Kodit NR. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPRK-së), sepse i njëjti më 1 qershor 2015, duke e drejtuar automjetin e tij kishte goditur këmbësorin i cili më pas kishte ndërruar jetë.
13. Më 25 shtator 2015, Prokuroria Themelore në Mitrovicë (në tekstin e mëtejme: Prokuroria), nxori Aktvendimin [PP-II nr.719/2015] mbi fillimin e hetimeve kundër parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se në rastin konkret duhet të mbliidhen prova tjera.
14. Më 5 shtator 2017, Prokuroria ngriti Aktakuzën [PP. II. nr.719/2015] kundër parashtruesit të kërkesës, nën dyshimin e bazuar se i njëjti kishte kryer veprën penale “*Rrezikim i Trafikut Publik*” nga pika 9, paragrafi 1 i nenit 378 të KPRK-së.
15. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 24 shkurt 2020, gjatë shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën Themelore parashtruesi i kërkesës kishte pranuar fajsinë lidhur me akuzën që i vihej barrë.
16. Më 26 shkurt 2020, përmes Aktgjykimit [P. nr. 232/2017] Gjykata Themelore, shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për kryerjen e veprës penale “*Rrezikim i Trafikut Publik*” nga pika 9, paragrafi 1 i nenit 378 të KPRK-së, duke e dënuar me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.
17. Më 7 korrik 2020, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë pranë Gjykatës së Apelit, kundër Aktgjykimit [P. nr. 232/2017] të Gjykatës Themelore të 26 shkurtit 2020, duke theksuar se i njëjti është marrë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe ligjit penal, si dhe për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal. Në mënyrë specifike parashtruesi i kërkesës pretendoi se në rastin e tij aktakuza është ngritur jashtë afateve të përcaktuara ligjore, respektivisht dy vite pas ngritjes së kallzimit penal.
18. Më 30 prill 2021, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PA1. nr. 746/2020], aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës duke anuluar aktgjykimin e ankimuar dhe vendosi që lënda të kthehet në rigjykim para gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e Apelit konstatoi se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të parapara me pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 394, pikën 12 të paragrafit 1 të nenit 384, lidhur me nenin 37, par. 7 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPPRK-së), ngase gjykata e shkallës së parë ka aprovuar deklaratën e të akuzuarit për pranimin e fajësisë pa u plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 248 të KPPRK-së, dhe ka vepruar në kundërshtim me shkresat e lëndës, dhe pastaj bazuar në kundërthëniet e provave personale dhe materiale me pranimin e fajësisë, gjykata e shkallës së parë nuk është dashur ta aprovoj të njëjtën.
19. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës lidhur me tejkalimin e afatit për ngritje të aktakuzës, Gjykata e Apelit konstatoi faktin se, “*gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar në kundërshtim me nenin 158, lidhur me nenin 159 të KPPRK-së, pasi*

edhe sipas mendimit juridik të Gjykatës Supreme të datës 29 shtator 2016, nuk llogaritet ky afat në lidhje me kohën e paraqitjes së kallëzimit penal, mirëpo afati rrjedh nga momenti i nxjerrjes së aktvendimit mbi fillimin e hetimeve, e siç rezulton nga arsyetimi i aktakuzës, prokuroria hetimet i ka filluar me datë 25 shtator 2015 dhe aktakuza është ngritur më 5 shtator 2017, pra pa kaluar afati 2 vjeçar i përfundimit të hetimeve sipas nenit 158 (Pushimi i hetimit) në ndërlidhje me nenin 159 (Afatet kohore të hetimit) të KPPRK-së. Derisa sa i përket pretendimit për hedhjen e kallëzimit penal brenda 30 ditëve, i njëjti është i bazuar, mirëpo ligjvënësi nuk ka paraparë pasoja juridike në rast mosveprimi sipas nenit 82 të KPPRK-së, po ashtu nuk ka paraparë pasoja juridike edhe lidhur me rrjedhën e procedurës hetimore prej 2 vitesh. Bazuar në një gjendje të tillë të fakteve Kolegji i apelit vendosi si në dispozitiv të aktvendimit”.

20. Më 21 shkurt 2023, Gjykata Themelore, pas kthimit të lëndës nga Gjykata e Apelit, ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën parashtruesi i kërkesës është deklaruar i pafajshëm, ndërsa Gjykata Themelore e ka njoftuar të njëjtin dhe përfaqësuesin e tij, se jo më vonë se 30 ditë nga mbajtja e shqyrtimit fillestarë kanë të drejtë të paraqesin kundërshtimet në lidhje me provat e cekura në aktakuzë dhe kërkesë për hedhjen e aktakuzës.
21. Më 22 mars 2023, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për hedhje të aktakuzës pranë Gjykatës Themelore, duke theksuar se (i) aktakuza është ngritur në tejkalim të afateve kushtetuese dhe ligjore, (ii) nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se parashtruesi i kërkesës ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.
22. Më 5 maj 2023, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [P. nr. 205/21], refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për hedhjen poshtë të aktakuzës. Gjykata e Themelore lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se aktakuza është ngritur pas afatit ligjor, në kundërshtim me nenin 158 (Pushimi i hetimit) dhe 159 (Afatet kohore të hetimit) të KPPRK-së, por edhe mendimit juridik të Gjykatës Supreme në të cilin thirret parashtruesi i kërkesës, të njëjtin e refuzoi si të pabazuar duke vlerësuar se ky afat llogaritet nga koha kur është nxjerrë aktvendimi për fillimin e hetimeve, e që nga shkresat e lëndës konstatohet se kallzimi penal është paraqitur me 25 shtator 2015, ndërsa aktakuza është paraqitur më 5 shtator 2017, pra brenda afatit dyvjeçar. Lidhur me pretendimin për hedhjen e kallëzimit penal brenda 30 ditëve, gjykata e njëjtë vlerësoi se ligjvënësi nuk ka paraparë pasoja juridike nëse nuk veprohet sipas nenit 84 (Masat e marra para fillimit të procedurës penale) të KPPRK-së.
23. Më tej, lidhur me pretendimet tjera të parashtruesit të kërkesës Gjykata Themelore thekson nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe në të cilat prokuroria i mbështet pretendimet e aktakuzës për të vërtetuar dyshimin e bazuar mirë, janë bindëse. Ndërsa se këto fakte të pretenduara në aktakuzë, a do të vërtetohen si të tilla për të rezultuar me fajësinë apo pafajësinë e parashtruesit të kërkesës, kjo është çështje që mbetet për t'u vlerësuar në fazën e shqyrtimit gjyqësor.
24. Më 29 maj 2023, parashtruesi i kërkesës, paraqiti ankesë pranë Gjykatës së Apelit, kundër Aktvendimit [P. nr. 504/21] të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, duke i propozuar të njëjtës, të aprovojë ankesën, ta hedhë poshtë aktakuzën dhe ta pushoj procedurën penale kundër tij.

25. Më 30 qershor 2023, Prokurori i Apelit në Prishtinë përmes parashtresës [PPN. nr. 361/2023], propozoi që ankesa e lartpërmendur e parashtruesit të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktvendimi i ankimuar të vërtetohet.
26. Më 4 korrik 2023, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PAN. nr. 698/2023], refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës kundër Aktvendimit [P. nr. 504/21] të Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit në arsyetim të aktgjykimit të saj theksoi se me pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me atë se aktakuza është nxjerrë jashtë afatit ligjor dhe se prokuroria në aktakuzë ka dështuar të vërtetoj që parashtruesi i kërkesës ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, ashtu që nuk është realizuar figura e veprës penale, gjykata e njëjtë vlerësoi se këto pretendime nuk janë të bazuara dhe se aktvendimi i ankimuar i shkallës së parë është i bazuar, i drejtë, i ligjshëm, i njëjti nuk përmban shkeljet për të cilat pretendohet në ankesë dhe as shkelje të tjera, si dhe është i qartë, konkret dhe arsyetimi i tij është në përputhje të plotë me dispozitivin. Më tej, thekson se *“... nuk ka vend për hedhje të akuzës, pasi vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri paraqet veprë penale, nuk ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale, nuk ka arrit afati i parashkrimit dhe nuk ka rrethana të tjera që e pengojnë ndjekjen penale dhe ka prova të mjaftueshme për një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet ...”*.
27. Më tej, Gjykata e Apelit thekson se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me gjendjen faktike sipas ekspertizës së 28 shtatorit 2015, dhe pretendimet e tjera në këtë fazë të procedurës penale janë të pabazuara, sepse gjykata e njëjtë nuk është e autorizuar të bëjë vlerësimin e provave në këtë fazë të procedurës, por vetëm të bëjë shqyrtimin e ligjshmërisë së nxjerrjes së provave dhe ngritjes së aktakuzës. Pretendimet dhe provat e bashkëngjitura nga parashtruesi i kërkesës do të vlerësohen dhe vërtetohen në shqyrtimin gjyqësor të mëtejshëm pas administrimit të provave, ku edhe do të vërtetohet fajësia apo pafajësia e parashtruesit të kërkesës në rastin konkret.
28. Më 5 dhjetor 2023, Gjykata Themelore mbajti shqyrtimin gjyqësor, i cili u ndërpre për shkak se përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës, kërkoi përjashtimin e gjyqtarit me arsyetimin se i njëjti në mënyrë të vazhdueshme po i bënte ndërhyrje në mbrojtje dhe konsideroi se u cenua mbrojtja efektive e të drejtave të parashtruesit të kërkesës, duke u bazuar në paragrafin 3 të nenit 38 të KPPK-së. Kjo kërkesë u pranua nga gjyqtari i vetëm gjykues i cili mori aktvendim për ndërprerje të shqyrtimit gjyqësor.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

29. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes aktvendimit të kontestuar, i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNj-së.
30. Parashtruesi i kërkesës fillimisht para Gjykatës thekson se në rastin konkret aktakuza kundër të njëjtit është paraqitur jashtë afatit kushtetues dhe ligjor, respektivisht pas kalimit të afatit dyvjeçar nga ngritje e kallëzimit penal. Kjo vonesë e Prokurorisë në ngritjen e aktakuzës e bën *“që e njëjta të jetë paraqitur në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 82, paragrafi 1, 158 paragrafi 3, 159 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Kodit të vjetër të Procedurës Penale”*.
31. Parashtruesi i kërkesës, po ashtu pretendon se është shkelur neni 31 i Kushtetutës, ashtu që aktvendimi i kontestuar është nxjerrë në zbatim të gabuar të dispozitave të

neneve 158 dhe 159 të Kodit të vjetër të Procedurës Penale, për shkak se i njëjti ka konfirmuar aktvendimin e Gjykatës Themelore, i cili gabimisht ka vërtetuar se aktakuza është nxjerrë brenda afatit ligjor, brenda afatit të hetimeve, me arsyetimin se aktvendimi për fillimin e hetimeve është nxjerrë më 25 shtator 2015, ndërsa aktakuza më 5 shtator 2017, pra brenda afatit prej 2 viteve. Sa i përket këtij arsyeimi, parashtruesi i kërkesës pretendon se i njëjti është në kundërshtim me mendimin juridik të Gjykatës Supreme nr. 583/2016 të 29 shtatorit 2016, i cili është nxjerrë pikërisht për t'i adresuar këto lloj raste, në të cilat prokuroritë nuk kanë vepruar brenda 30 ditëve për kallëzimet penale të pranuar.

32. Duke u bazuar në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme xxxxx, parashtruesi i kërkesës pretendon se duke qenë se Prokuroria nuk e ka hedhur poshtë kallëzimin penal, brenda afatit prej 30 ditëve, pas pranimit të të njëjtit më 11 qershor 2015, si dhe nuk ka urdhëruar ndonjëherë nga masat e fshehta teknike të hetimit dhe vëzhgimit. Atëherë me kalimin e këtij afati, konsiderohet se kanë filluar hetimet, pavarësisht se të njëjtat janë formalizuar me aktvendim për fillimin e hetimit apo jo. Bazuar në këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se në rastin konkret, hetimet ndaj parashtruesit të kërkesës ligjërisht kanë filluar më 12 korrik 2015, dhe rrjedhimisht aktakuza nga Prokuroria është dashur të ngritet më së largu deri më 11 korrik 2017. Duke qenë se Prokuroria ka ngritur aktakuzën më 5 shtator 2017, rezulton se e njëjta është jashtë periudhës kohore të përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 159, të KPRK-së, ky veprim paraqet shkelje të dispozitave të garancive kushtetuese të përcaktuara në nenin 31 të Kushtetutës.
33. Parashtruesi i kërkesës në mbështetje të pretendimeve të tij, thirret në disa raste të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (shih, rastin *Grigoryan kundër Armenisë*, nr. 3627/06, Aktgjykim i 12 korrikut 2012, paragrafi 125, *Eckle kundër Gjermanisë*, nr. 8130/78, Aktgjykim i 15 korrikut 1982, paragrafi 73, *Tororov kundë Ukrainës*, nr. 16717/05, Aktgjykim i 12 janarit 2012, paragrafi 84, gjithashtu *Dimitar Vasilev kundër Bullgarisë*, nr. 10902/05, Aktgjykim i 10 prillit 2012, paragrafi 25, si dhe rastin *Grishin kundër Rusisë*, nr. 14807/08, Aktgjykim i 24 korrikut 2012, paragrafi 168), lidhur me llogaritjen e kohëzgjatjes së procedurës penale dhe atë se si përkufizohet "akuza" sipas GjEDNj-së.
34. Parashtruesi i kërkesës pretendon gjithashtu mungesë të një vendimi të arsyetuar gjyqësor. Kjo për faktin se aktvendimi i kontestuar vërteton aktvendimin e Gjykatës Themelore mirëpo i mungon arsyeimi konkret, si dhe përdor terminologji të përgjithësuar, duke mos i adresuar pretendimet ankimore të parashtruesit të kërkesës sa i përket afatshmërisë së aktakuzës. Më tej thirret në praktikën e Gjykatës dhe GjEDNj-së sa i përket trajtimit të vendimeve gjyqësore të cilat kanë mungesë të arsyeimit (shih, rastin e Gjykatës KI87/18, parashtruesi *IF Skadeforsikring*, Aktgjykim i 15 prillit 2019, paragrafët 47 dhe 48, shih gjithashtu *Helle kundër Finlandës*, nr. 157/1996/776/977, Aktgjykim i 19 dhjetorit 1997, paragrafi 60). Tutje pretendon se, aktvendimi i kontestuar nuk i përmbushë kriteret e përcaktuara nga Gjykata për të qenë vendim gjyqësor i arsyetuar, për shkak se i njëjti: (i) me rastin e adresimit të pretendimeve ankimore të parashtruesit të kërkesës, i pranon thjeshtë dhe pa asnjë përpjekje konkluzionet e arritura nga Gjykata Themelore; dhe (ii) nuk jep arsye bindëse dhe të ndërtuar mirë ligjërisht me rastin e refuzimit të ankesës së parashtruesit të kërkesës.
35. Më tej, parashtruesi i kërkesës pretendon se aktvendimi i kontestuar, me aprovimin e qëndrimit të Gjykatës Themelore i cili thekson se nga ligjvënësi nuk janë paraparë pasoja në rast se nuk veprohet brenda 30 ditëve në lidhje me kallëzimin penal, po i mundëson Prokurorisë që duke mos respektuar parimin për një gjykim në një afat të

arsyeshëm, të mos i trajtojë kallëzimet penale me vite të tëra dhe pas çfarëdo periudhe kohore para parashkrimit të veprës t'i formalizojë hetimet përmes nxjerrjes së aktvendimit për fillimin e hetimeve. Kështu në rastin konkret, parashtruesi pretendon se duke vepruar në kundërshtim me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme nr 583/2016 të 10 nëntorit 2016, qëllimi i së cilit është eliminimi i këtyre praktikave, që të mos i mundësohet prokurorive që të vendosin se kur do të veprojnë në lidhje me kallëzimet penale të pranuar nga ana e tyre.

36. Parashtruesi i kërkesës i propozon Gjykatës: (i) Të deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) Të konstatojë se aktvendimi i kontestuar nuk është në përputhshmëri me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 31 të Kushtetutës dhe paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNj-së, (iii) Të shpallë të pavlefshëm aktvendimin e kontestuar; (iv) Ta kthejë çështjen në rivendosje në Gjykatën e Apelit të Kosovës, në përputhje me konstatimet e aktgjykimit.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

- 1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
- 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*

[...]

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

- 1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.*

[...]

KODI NR. 04/L-082 PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 378

Rrezikimi i trafikut publik

1.Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikon jetën e njerëzve apo pasurinë dhe me këtë i shkakton dikujt lëndim të lehtë trupor ose dëm pasuror, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.
[...]

9. Nëse vepra penale nga paragrafi 6. i këtij neni rezulton me vdekjen e një apo më shumë personave, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet.

KODI Nr. 04/L-123 I PROCEDURËS PENALE

Neni 82

Hedhja e kallëzimit penal të policisë

1. Prokurori i shtetit me aktvendim e hedh kallëzimin penal të pranuar nga policia apo burime tjera brenda tridhjetë (30) ditëve, nëse nga raporti është e qartë se:

1.1. nuk ekziston dyshim i arsyeshëm se është kryer vepër penale;

1.2. ka kaluar afati i parashkrimit për ndjekje penale;

1.3. vepra penale është përfshirë me amnisti ose me falje;

1.4. i dyshuari gëzon imunitet dhe heqja e tij nuk është e mundur ose nuk është miratuar nga organi kompetent; ose

1.5. ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e përjashtojnë ndjekjen.

2. Prokurori i Shtetit menjëherë një kopje të aktvendimit sipas paragrafit 1. të këtij neni ia dërgon policisë.

3. Prokurori i Shtetit brenda tetë (8) ditësh nga hedhja e kallëzimit njofton të dëmtuarin për hedhjen e kallëzimit dhe arsytet për këtë.

Neni 84

Masat e marra para fillimit të procedurës penale

1. Nëse prokurori i shtetit ka dyshim të bazuar se është kryer vepër penale nga neni 90 të këtij Kodi, po kryhet apo së shpejti do të kryhet, prokurori i shtetit mund të autorizojë apo të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprake që të autorizojë masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit në pajtim me nenet 86-100 të këtij Kodi.

2. Për autorizimin e masave të fshehta dhe teknike të hetimit dhe vëzhgimit nga paragrafi 1, prokurori i shtetit ose gjyqtari i procedurës paraprake nuk është e domosdoshme të ketë dyshim të arsyeshëm për identitetin e të dyshuarit apo të dyshuarve të cilët kanë kryer, janë duke kryer ose së shpejti do të kryejnë vepër penale.

3. Nëse autorizimi për masa të fshehta dhe teknike të hetimit dhe vëzhgimit bazohet, tërësisht apo pjesërisht, mbi dyshimin e bazuar të siguruar përmes informatave të dhëna nga informatori, dëshmitari apo dëshmitari bashkëpunues, prokurori i shtetit mund të marrë në pyetje atë informator, dëshmitar apo dëshmitar bashkëpunues.

4. Procedura penale nuk kërkohet që të jetë filluar për autorizimin nga prokurori i shtetit apo gjyqtari i procedurës paraprake të masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit nga paragrafi 1; sidoqoftë, procedura penale fillohet posa prokurori i shtetit të ketë dyshim të arsyeshëm për identitetin e të dyshuarit apo dyshuarve që kanë kryer vepër penale.

5. Nëse masat e fshehta apo teknike të vëzhgimit apo hetimit janë autorizuar në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni prokurori i shtetit ndërmerr masa të arsyeshme për ruajtjen e privatësisë së personave që nuk janë të përfshirë në vepër penale.

6. Nëse procedura penale autorizohet pasi ndërmarrjes së masave të fshehta apo teknike të vëzhgimit apo hetimit nga paragrafi 1 të këtij neni, prokurori i shtetit i

bashkëngjet në procesverbal të procedurës penale urdhrat për masat e fshehta apo teknike të vëzhgimit apo hetimit dhe provat që rezultojnë nga to.

7. Nëse prokurori i shtetit nuk autorizon procedurë penale pas ndërmarrjes së masave të fshehta apo teknike të vëzhgimit apo hetimit nga paragrafi 1. të këtij neni, prokurori i shtetit raporton tek gjyqtari i procedurës paraprake mbi masat e ndërmarra.

Neni 158 Pushimi i hetimit

1. Prokurori i shtetit e pushon hetimin kurdo që është vërtetuar nga provat e mbledhura se:

1.1. nuk ekziston dyshim i arsyeshëm që personi konkret e ka kryer veprën e tillë penale;

1.2. vepra e kryer nuk është vepër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare;

1.3. ka kaluar afati i parashkrimit;

1.4. vepra penale është përfshirë në falje ose në amnistinë e lëshuar para miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; ose

1.5. vepra penale është përfshirë në amnistinë e lëshuar para miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

1.6. ekzistojnë rrethana të tjera të cilat përjashtojnë ndjekjen.

2. Prokurori i shtetit brenda tetë ditësh pas pushimit të hetimit e lajmëron të dëmtuarin për këtë fakt dhe arsyet për këtë. Prokurori i shtetit pa vonesë e njofton gjyqtarin e procedurës paraprake për pushimin e hetimit.

3. Hetimi pushon automatikisht me kalimin e afatit kohor nga neni 159 të këtij Kodi.

Neni 159 Afatet kohore të hetimit

1. Kur fillohet hetimi, hetimi përfundon brenda dy (2) viteve. Nëse brenda dy (2) viteve nga fillimi i hetimit paraprak nuk është ngritur aktakuzë, ose nuk është pezulluar hetimi sipas nenit 157 të këtij Kodi, hetimi menjëherë pushohet.

2. Gjyqtari i procedurës paraprake mund të autorizojë një vazhdim deri në gjashtë (6) muaj të hetimit nga paragrafi 1. të këtij neni, në rastet kur hetimi penal është i ndërlikuar, përfshirë por pa u kufizuar kur ka katër apo më shumë të pandehur, janë identifikuar disa të dëmtuar, është bërë kërkesa për ndihmë juridike ndërkombëtare, apo ekzistojnë rrethana tjera të jashtëzakonshme.

3. Nëse i pandehuri është arrestuar dhe mbahet në paraburgim, gjyqtari i procedurës paraprake nuk urdhëron vazhdimin nga paragrafi 2. të këtij neni apo vazhdimin e paraburgimit përveç nëse prokurori i shtetit tregon se hetimi po zbatohet në mënyrë aktive dhe vonesat janë jashtë kontrollit të tij.

Neni 384 Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale

1. Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiderohet nëse:

[...]

1.5. gjykata ka shkelur dispozitat e procedurës penale lidhur me çështjen nëse ekziston akuzë e prokurorit të autorizuar, propozimi i të dëmtuarit ose leja e organit publik kompetent;

[...]

1.8. aktgjykimi bazohet në provë të papranueshme;

1.9. i akuzuari i thirrur të deklarohet mbi fajësinë nuk e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës ose ndonjë pikë të saj dhe është marrë në pyetje para prezentimit të provave;

2. Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiderohet edhe kur gjatë procedurës penale, duke përfshirë edhe procedurën paraprake, gjykata, prokurori i shtetit dhe policia:

2. 1. nuk kanë zbatuar ndonjë dispozitë të këtij kodi ose kanë zbatuar gabimisht;

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

37. Gjkata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

38. Në këtë drejtim, Gjkata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjkata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

39. Në vijim, Gjkata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar edhe kushtet e pranueshmërisë siç përcaktohen në Ligj dhe në Rregullore të punës. Në këtë drejtim, Gjkata i referohet fillimisht nenit 47 (Kërkesa individuale) dhe pikës (b) të paragrafit (1) të rregullit 34 të Rregullores së punës:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjkata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Rregulli 34 Kriteret e pranueshmërisë

(1) Gjkata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

(b) Janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me ligj kundër aktit të kontestuar;

40. Gjykata rikujton se rregulli për shterimin e mjeteve juridike sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 34 (1) (b) të Rregullores së punës i obligon ata që dëshirojnë të paraqesin rastin e tyre në Gjykatën Kushtetuese që së pari duhet të shfrytëzojnë mjetet juridike efektive në dispozicion në pajtim me ligjin, kundër një aktgjykimi ose vendimi të kontestuar.
41. Para se të vazhdojë me vlerësimin e kriterëve të shterimit të mjeteve juridike në rastin konkret, Gjykata do të përmbledhë faktet e rastit konkret për të shqyrtuar më qartë pjesën e procedurës e cila ka rezultuar me aktvendimet e kontestuara të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit, të cilat parashtruesi i kërkesës pretendon se kanë rezultuar në shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, sepse i) aktakuza është ngritur jashtë afateve ligjore dhe se ii) vendimet janë të paarsyetuara.
42. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton rrethanat e rastit konkret që kanë të bëjnë fillimisht me një kallëzimin penal kundër parashtruesit të kërkesës, nën dyshimin e bazuar se i njëjti ka kryer veprën penale “*Rrezikim i Trafikut Publik*” të KPRK-së, dhe më 25 shtator 2015, Prokuroria nxori aktvendim për fillimin e hetimeve kundër parashtruesit të kërkesës. Më 5 shtator 2017, Prokuroria ngriti aktakuzën kundër parashtruesit të kërkesës, nën dyshimin e bazuar se i njëjti kishte kryer veprën penale të lartcekur. Gjykata Themelore e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për veprën penale për të cilën akuzohej, duke e dënuar me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti. Pas ankesës së parashtruesit në Gjykatën e Apelit, ku në mënyrë specifike parashtruesi i kërkesës pretendoi se në rastin e tij aktakuza është ngritur jashtë afateve të përcaktuara ligjore, respektivisht dy vite pas ngritjes së kallzimit penal. Gjykata e Apelit aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës ashtu që anuloi aktgjykimin e ankimuar dhe vendosi që lënda të kthehet në rigjykim para gjykatës së njëjtë. Gjykata e Apelit konstatoi se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, ngase gjykata e shkallës së parë ka aprovuar deklaratën e të akuzuarit për pranimin e fajësisë pa u plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 248 të KPPRK-së, dhe ka vepruar në kundërshtim me shkresat e lëndës, dhe pastaj bazuar në kundërthëniet e provave personale dhe materiale me pranimin e fajësisë, gjykata e shkallës së parë nuk është dashur ta aprovoj të njëjtën. Lidhur me pretendimet e parashtruesit se aktakuza është ngritur jashtë afatve të përcaktuara ligjore, Gjykata e Apelit refuzoi të njëjtat si të pabazuara. Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për hedhje të aktakuzës pranë Gjykatës Themelore, ku kjo e fundit refuzoi të njëjtën si të pabazuar. Vendimi i Gjykatës Themelore ishte aprovuar edhe nga Gjykata e Apelit. Më 5 dhjetor 2023, Gjykata Themelore mbajti shqyrtimin gjyqësor, i cili u ndërpre për shkak se avokati i parashtruesit të kërkesës, kërkoi përjashtimin e gjyqtarit me arsyetimin se i njëjti në mënyrë të vazhdueshme po i bënte ndërhyrje në mbrojtje dhe konsideroi se u cenua mbrojtja efektive e të drejtave të parashtruesit të kërkesës, duke u bazuar në dispozitat e nenit 38, par.3 të KPPK-së.
43. Parashtruesi në mënyrë specifike para Gjykatës konteston vendimin e Gjykatës së Apelit, i cili vërtetoi vendimin e shkallës së parë me të cilin iu refuzua kërkesa e parashtruesit për hedhje poshtë të aktakuzës. Parashtruesi pretendon se përmes vendimit të kontestuar i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNj-së.
44. Megjithatë nga shkresat e lëndës rezulton se rasti është duke u zhvilluar në shqyrtim kryesor në Gjykatën Themelore në rigjykim.

45. Prandaj, në mënyrë që Gjykata të përcaktojë fazën në të cilën ndodhet procedura penale e parashtruesit të kërkesës, i referohet dispozitave të Kodit të Procedurës Penale që ishte në fuqi në rastin e parashtruesit të kërkesës. Bazuar në nenin 68 (Fazat e procedurës penale) të Kodit nr. 04/L-123 për procedurën penale, Gjykata dëshiron të theksojë se “*Procedura penale ka katër faza të ndryshme: (i) fazën e hetimit, (ii) fazën e ngritjes së aktakuzës dhe deklarimit, (iii) fazën e shqyrtimit gjyqësor dhe (iv) fazën e mjetit juridik*”.
46. Sipas gjendjes faktike, Gjykata konstaton se rasti i parashtruesit të kërkesës në momentin e paraqitjes së kërkesës në Gjykatë ishte në (iii) *fazën e shqyrtimit gjyqësor*, në Gjykatën Themelore. Gjykata konstaton gjithashtu se vetë faza e shqyrtimit gjyqësor përbëhet nga një numër i madh veprimesh dhe çështjesh procedurale që duhet të ndërmerren dhe të shtrohen si nga pala paditëse ashtu edhe nga mbrojtja dhe gjykata. Pikërisht nga veprimet e tilla procedurale mund të lindin faza të ndërmjetme, në të cilat çështjet dhe procedurat individuale zgjidhen me përdorimin e mjeteve juridike të përcaktuara me ligj me qëllim të drejtimit të rrjedhës së procedurës penale.
47. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës në rastin konkret i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike në procedurë lidhur me pretendimet të cilat i ka ngritur në Gjykatë, për të cilën konsideron se është shkelur me aktvendimet e Gjykatës Themelore dhe asaj të Apelit.
48. Gjykata, në vlerësimin e detyrimit për shterimin e të gjitha mjeteve juridike “*efektive*” juridike, rikujton se vlerësimi nëse ky detyrim është përmbushur është i përcaktuar mirë në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, në pajtim me të cilin, sipas nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, Gjykata është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Të njëjtat parime janë shtjelluar dhe zbatuar në praktikën e konsoliduar të Gjykatës, ku përfshihen edhe kërkesat që janë shqyrtuar në procedura civile, penale dhe administrative.
49. Siç është sqaruar përmes praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, të afirmuar edhe përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës, bazuar në parimin e subsidiaritetit, qëllimi dhe arsyeimi i detyrimit për të shteruar mjetet juridike ose rregulli i shterimit, është që t'u ofrojë autoriteteve përkatëse, para së gjithash gjykatave të rregullta, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Ky detyrim bazohet në supozimin që pasqyrohet në nenin 32 [E drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës dhe në nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNj-së, se rendi juridik i Republikës së Kosovës siguron mjete efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të makinerisë së drejtësisë kushtetuese (shih rastet e Gjykatës; [KI106/21](#), parashtrues *Bujar Shehu dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 janarit 2022; [KI43/20](#), parashtruese *Fitore Sadikaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 31 gushtit 2020, paragrafi 37; dhe [KI42/20](#), parashtrues *Armend Hamiti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 31 gushtit 2020, paragrafi 44; [KI35/23](#), parashtrues *Pajtim Shabani*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 qershorit 2023 dhe shih gjithashtu rastet e GjEDNj-së *Vernillo kundër Francës*, nr. 11889/85, Aktgjykimi i 20 shkurtit 1991, paragrafi 27; *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803/94, Aktgjykim i 28 korrikut 1999; *Kudla kundër Polonisë* [DHM], nr. [30210/96](#), Aktgjykim i 26 tetorit 2000, paragrafi 152, *Andrásik dhe të tjerët kundër Sllovakisë*, nr. 57984/00 dhe 6 kërkesa të tjera, Vendim i 22 tetorit 2022).

50. Nga sa më sipër, rezulton se prioriteti i mbrojtjes gjyqësore të të drejtave në gjykatat e rregullta dhe i së drejtës për mjete juridike efektive është një aspekt shumë i rëndësishëm i mbrojtjes së të drejtave të njeriut që gjykatat e rregullta duhet ta kenë parasysh dhe që merret parasysh edhe nga Gjykata Kushtetuese, nëse një rast i tillë, parashtrohet nga personat e autorizuar edhe pas përmbushjes së kritereve të pranueshmërisë, duke përfshirë shterimin e mjeteve juridike.
51. Gjatë vlerësimit nëse pretendimet e lartpërmendura të parashtruesit të kërkesës mund të paraqiten në procedurat e mëtejshme të procedurës penale, e cila është ende duke u zhvilluar, Gjykata do t'i referohet: (i) dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Penale, të cilat parashohin faza të ndryshme të zbatimit të procedurës penale; (ii) arsyetimin e Gjykatës së Apelit përmes së cilit është pranuar si e bazuar ankesa e parashtruesit dhe çështje kryesore për caktimin e fajsisë është kthyer në rigjykim; (iii) parimi që përcakton se drejtësia e procedurës penale duhet të shqyrtohet në tërësi; dhe (iv) detyrimin e gjykatave të rregullta që gjatë kryerjes së procedurës penale të zbatojnë standardet dhe garancitë e përcaktuara në nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së dhe parimet e vendosura përmes praktikës gjyqësore të GjEDNj-së.
52. Duke iu kthyer rastit konkret, dhe duke shqyrtuar shkresat e lëndës, rezulton se parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë pranë Gjykatës së Apelit, kundër Aktgjykimit [P. nr. 232/2017] të Gjykatës Themelore të 26 shkurtit 2020, duke theksuar se i njëjti është marrë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe ligjit penal, dhe për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal. Në mënyrë specifike parashtruesi i kërkesës pretendoi se në rastin e tij aktakuza është ngritur jashtë afateve të përcaktuara ligjore, respektivisht dy vite pas ngritjes së kallzimit penal. Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [PA1. nr. 746/2020] aprovoi ankesën e parashtruesit dhe çështjen e ktheu në rigjykim.
53. Megjithatë, siç është alabouruar edhe tek pjesa e fakteve, rasti është ende në fazën e shqyrtimit kryesor, respektivisht më 5 dhjetor 2023, Gjykata Themelore mbajti shqyrtimin gjyqësor, i cili u ndërpre për shkak se përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës, kërkoi përjashtimin e gjyqtarit me arsyetimin se i njëjti në mënyrë të vazhdueshme po i bënte ndërhyrje në mbrojtje dhe konsideroi se u cenua mbrojtja efektive e të drejtave të parashtruesit të kërkesës, duke u bazuar në dispozitat e nenit 38, par. 3 të KPPK-së. Kjo kërkesë u pranua nga gjyqtari i vetëm gjykues i cili mori aktvendim për ndërprerje të shqyrtimit gjyqësor.
54. Në lidhje me këtë dhe bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së dhe nga vetë Gjykata, u theksua se drejtësia e procedurës duhet të shqyrtohet në tërësi (shih rastin e Gjykatës KI14/18, parashtrues *Hysen Kamberi*, aktgjykim i 15 janarit 2020, paragrafi 43).
55. Gjykata, pas shqyrtimit të dispozitave ligjore përkatëse që i ka përmendur në pjesën përkatëse të aktvendimit, respektivisht tek dispozitat relevante ligjore, ka konstatuar se parashtruesi i kërkesës në kuadër të KPPRK-së dhe në pajtim me parimin e subsidiaritetit mund të paraqesë pretendimet e tij për ngritjen e aktakuzës jashtë afatve të përcaktuara ligjore dhe pretendimin për mungesë të arsyetimit të vendimit, gjatë shqyrtimit penal në procedurën në gjykatat e rregullta, siç parashihet me dispozitat përkatëse të KPPRK-së. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se: (i) pika 5,8 dhe 9 të paragrafit 1 dhe pika 1 e paragrafit 2 të nenit 384 (Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale) i KPPRK-së nr. 04/L-123 përcakton se shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale konsiderohen vetëm ato shkelje që kanë ndikuar në

marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë; ii) në nenin 329 (Rregullat e përgjithshme të paraqitjes së provave), në paragrafin 3 theksohet qartë se deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, palët mund të propozojnë shqyrtimin e fakteve të reja, mbledhjen e provave të reja dhe përsëritjen e propozimeve, të cilat gjyqtari i vetëm, kryetari i trupit gjykues ose trupi gjykues i kishin refuzuar më parë. Gjithashtu, e njëjta çështje mund të jetë objekt shqyrtimi edhe në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, e cila në nenin 432 (Arsyet për paraqitje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) përcakton që pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë mund të paraqitet kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë për shkak të shkeljes esenciale të procedurës penale dhe shkeljeve tjera që kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor.

56. Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës, në kontekstin e ligjit aktual procedural të KPPRK-së dhe në pajtim me parimin e subsidiaritetit, ende mund t'i paraqesë pretendimet e tij gjatë procedurës penale kryesore pranë gjykatave të rregullta, siç parashihet me dispozitat përkatëse të KPPRK-së, gjegjësisht neni 384 (Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale), neni 329 (Rregullat e përgjithshme të paraqitjes së provave) dhe neni 432 (Arsyet për paraqitje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) e cila gjithashtu mund të dorëzohet pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë për shkak të shkeljes esenciale të procedurës penale dhe shkeljeve të tjera që kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor.
57. Në fund, Gjykata dëshiron të theksojë detyrimin kushtetues, i cili përcaktohet në paragrafin 3, të nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës, që gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit. Prandaj, Gjykata gjithashtu dëshiron të theksojë se detyrimi për interpretimin e të drejtave të njeriut në përputhje me praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, i cili është i paraparë me nenin 53 të Kushtetutës, vlen edhe për gjyqësorin e rregullt. Prandaj, Gjykata vlerëson se gjykatat e rregullta, në pajtim me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve, duhet të zbatojnë parimet dhe standardet që janë zhvilluar përmes praktikës gjyqësore të GjEDNj-së dhe që u referohen garancive të përcaktuara në nenet 30 dhe 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së.
58. Në dritën sa më sipër, Gjykata, duke marrë për bazë faktin se procedura penale kundër parashtruesit të kërkesës, përkatësisht shqyrtimi gjyqësor në procedurën penale kundër tij është duke u zhvilluar dhe bazuar në parimin e përcaktuar se procedura penale duhet të vlerësohet në tërësi, vlerëson se pretendimet e tij që kanë të bëjnë me i) pretendimin e tij se aktakuza është ngritur jashtë afateve të përcaktuara ligjore janë pretendime të parakohshme.
59. Gjykata deri më tani në praktikën e saj gjyqësore ka përcaktuar se nëse procedurat janë duke u zhvilluar në gjykatat e rregullta, atëherë kërkesa e parashtruesve të kërkesës konsiderohet e parakohshme (shih rastin e Gjykatës: KI35/23, parashtruesi: *Pajtim Shabani*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 qershorit 2023, paragrafi 54).
60. Andaj, për sa i përket respektimit të parimit të subsidiaritetit, Gjykata vlerëson se kërkesa e parashtruesit në këtë fazë të procedurës është e parakohshme.
61. Gjykata dëshiron të theksojë se ky konkluzion i Gjykatës nuk e pengon parashtruesin e kërkesës që në të ardhmen të parashtrojë përsëri ankesë kushtetuese brenda afatit ligjor dhe pas përfundimit të procedurës penale kundër tij si dhe pas shterimit të të gjitha mjeteve efektive juridike të përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi.

62. Në fund, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit është e parakohshme dhe në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe në bazë të rregullit 34 (1) (b) të Rregullores së punës, duhet të deklarohet si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 27 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullat 34 (1) (b), 44 dhe 45 të Rregullores së punës, më 4 shtator 2024, njëzëri,

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues


Enver Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani